



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.DH.Shk II.nr.1474/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Ergot BFC” SH.P.K., me NUI: 810081068, me seli në rrugën “Uran Tinova”, në Ferizaj, kundër debitorit Ministria e Shëndetësisë - Qendra e Shëndetit Mendor, me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.589/23 të datës 24.03.2023, me datë **05.03.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Ergot BFC” SH.P.K., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.589/23 të datës 24.03.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.589/23 të datës 24.03.2023 në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit Ministria e Shëndetësisë - Qendra e Shëndetit Mendor dhe ka anuluar Urdhrin Përmbartimor P.nr.151/2023 i datës 24.03.2023, i Përmbartuesit Privat Besnik H. Aliu, ashtu që është përfunduar në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.589/23 të datës 24.03.2023,, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Ankesa e kreditorit i është dorëzuar debitorit për përgjigje, mirëpo i njëjti nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Ergot BFC” SH.P.K., me datën 24.03.2023 ka paraqitur propozimin për përmbarrim në bazë në bazë të dokumentit –Faturës nr.22-SHV01-001-2 të datës 15.09.2022 dhe Faturës Nr.22- SHV01-001-3 të datës 16.09.2022, duke urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, t’ia paguaj borxhin në shumën prej 1,860.00€, me kamatë ligjore prej 8%, nga data e kalimit të afatit për pagesë e deri në përmbushjen definitive, si dhe të gjitha shpenzimet përmbarrimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit.

Përmbarruesi Besnik H.Aliu me seli në Ferizaj duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit me urdhrin përmbarrimor P.nr.151/2023 dt.24.03.2023 e ka lejuar përmbarrimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim ndaj Urdhrit Përmbarrimor duke kundërshtuar në tërësi urdhrin e lejuar për përmbarrim me arsyetimin se sa i përket faturave në bazë të së cilave është lejuar përmbarrimi, pagesa e tyre është bërë me datë 18.10.2022 dhe Operatorit Ekonomik dhe kontabilistit të kreditorit i janë dërguar me datë 21.02.2022 dëshmia e pagesës pasi që kanë kërkuar informacion rreth pagesës së kryer. Më tutje ka theksuar se, pas kontaktit me zyrtarët e në Thesarin e Kosovës, debitori është informuar se pagesa është ekzekutuar për përfitimin e cekur, por që e njëjta është ndaluar nga Thesari me Urdhër të Administratës Tatimore për borxhe të saj, dhe shkak të borxheve të kreditorit ndaj ATK –së, nuk janë transferuar mjetet në llogarinë bankare të kreditorit. Gjykatës i ka propozuar që të pranohet prapësimi si i bazuar dhe të anulohet Urdhri Përmbarrimor P.nr.151/2023 i datës 24.03.2023.

Kreditori në përgjigjen në prapësim, ka kundërshtuar pretendimet e debitorit duke theksuar se debitori nuk e ka bazuar prapësimin e tij në asnjë nga shkaqet e parapara me nenin 71 të LPPsë. Tutje ka shtuar se, borxhi nuk është paguar asnjëherë pasi që në llogaritë bankare të kreditorit nuk është pranuar asnjëherë një pagesë e tillë. Ka theksuar se, nuk ekzistojnë kushtet për anulimin e urdhrin përmbarrimor pasi që faturat i përmbajnë tiparet e dokumenteve të besueshme siç parashihet me ligj. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi Urdhri Përmbarrimor P.nr.151/2023 i datës 24.03.2023

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.589/23 të datës 17.07.2023, ku në dispozitivin e aktvendimit e ka pranuar prapësimin e debitorit Ministria e Shëndetësisë - Qendra e Shëndetit Mendor dhe ka anuluar Urdhrin Përmbarrimor P.nr.151/2023 i datës 24.03.2023, i Përmbarruesit Privat Besnik H. Aliu, ashtu që është përfunduar në tërësi përmbarrimi në këtë çështje përmbarrimore.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbarrim dhe i lejuar me urdhrin e

Përmbaruesit Privat Besnik H.Aliu, P.nr.151/2023 e datës 24.03.2023, në shumën prej 1,860.00 € (njëmijë e tetëqind e gjashtëdhjetë euro) është përmbushur në tërësi.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkallës së dytë bazuar provat që gjenden në shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimin e debitorit se faturat nuk përmbajnë nënshkrimin e tij andaj si e tillë është e përshtatshme për përmbarim, por që nga shkresat e lëndës Gjykata gjeti se debitori ka bashkangjitur urdhërpagesën me nr.71201035e datës 18.10.2022 nga e cila vërtetohet se debitori ka përmbushur obligimin në shumën prej 1,860.00 EUR dhe atë në emër të borxhit për faturën nr.22-SHV01-001-2 të datës 15.09.2022 dhe faturën Nr.22- SHV01-001-3 të datës 16.09.2022, andaj duke u mbështetur në nenin 71 par.1 nën par.1.2, të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”* gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur, pasi që dokumenti i besueshëm – faturat në bazë të të cilave është lejuar urdhri përmbarimor, e kanë humbur efektin juridik.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit por te njëjtat mbesin te pabazuara pasi nuk ka arrit ti argumentoj me prova juridikisht te vlefshme ashtu siç kërkon neni 69.4 i LPP dhe si te tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj. Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
**Dhoma e shkallës së dytë**  
**K.DH.Shk II.nr.1474/23, me datë 05.03.2024**

**Gjyqtari**  
**Faton Bajrami**